

JORGJI GJINARI

VËZHGIME MBI TË FOLME TË KRUIJËS DHE TË MALËSISË
SË KRUIJËS II

MORFOLOGJIA

Emri

Gjinia, trajta. Emrat *gjeth-i*, *tagji-ni*, *naft-i* janë të gjinisë mashkullore, kurse emrat : *p Φ ll-a* (pylli), *qill-a*, *hasër-hasra*, *ust ϵ -ja*, *qiri-ja* janë të gjinisë femërore. I gjinisë femërore është edhe emri *dr \ddot{u} -ja* kur kuptimi i tij është për dru të prerë, copë dru, kurse është i gjinisë mashkullore *dru-ni* kur ka kuptimin e një peme.

Emrat mashkullore, që mbarojnë në trajtën e pashqar me *u* të ardhur nga monoftongimi i diftongut *ue*, nuk e nxjerrin bashkëtingëlloren *n* të temës së vjetër në trajtën e shqar: *falk \ddot{u} -falkoi*, *ft \ddot{u} -ft \wedge* .

Emrat mashkullore që mbarojnë me *ur* (uer), *ull* (uell) kur shquhen nuk kthehen në gjendjen e mëparëshme me *or*, *oll*, kështu: *qershur-i*, *krah \ddot{u} -i*, *plur-i*, *shull-i*.

Numuri. — Do të flasim këtu vetëm për shumësin e emrave mashkullore.

Forma më e përhapur e shumësit është ajo me mbaresën *a*. Me këtë mbaresë në të folmen e qytetit dhe në atë të Malësisë e formojnë shumësin një mori emrash të kategorive të ndryshme, prej të cilëve në toskërisht disa e formojnë me *a*, disa me *ë*, disa të tjerë me *e*, disa më *ënj*, *inj* e në mënyra të tjera:

a) *emna*, *plisa*, *gjela*, *kanila*, *xhepa*, *krima*, *rr Φ pa*, *qylyma*, *çelsa*, *viça*, *pjepna*, *keca*:

b) *oficera*, *toktorra* (doktorë), *kapidana*, *ortodoksa*, *avukata*, *jet 3 ma*, *kumita*, *kraha*, *çamadana*, *cugala*, *brina*, *veca*, *gjysha*, *msusa*.

c) *tasa*, *kavalla*, *pusa*, *saça*, *rrapa*, *tunca*, *kryg ϵ za*, *trapa*;

ç) *l \ddot{a} ma*, *l \ddot{a} msha*, *m \ddot{a} za*, *drapna*, *gjarpna*, *gishta*, *ma η alla*, *bakulla*.

d) *dh \ddot{a} nrra*, *deja*, *viska*, *lepra*.

I përhapur është edhe shumësi me mbaresën *na* (këtu janë bashkuar $\bar{e}n + a$): *lumna*, *gardhna*, *hajdutna*, *p Φ llna*, *dacna*, *dellna*, *çifutna*, *l \ddot{a} mna* edhe *projna* (tek ky i fundit formës me *j* i është shtuar mbaresa *na*).

Shumë nga emrat që në numurin njëjës mbarojnë me zanore në shumës marrin mbaresën *j* (\bar{i}) e cila dikur ka qenë *nj* : *pe \bar{i}* , *ull $\bar{3}$* *kal $\bar{3}$ \bar{i}* , *mt \bar{i}* , *ft \wedge \bar{i}* , *vargo \bar{i}* , *prro \bar{i}* , *k \bar{u}* , *dr \bar{u}* , *shkopi \bar{i}* , *kalama \bar{i}* . Emrat që mbarojnë në njëjës me *ll*, në shumës e alternojnë atë me bashkëtingëlloren *j*- (e ardhur prej palatalizimit të *ll*-së): *maskhi \bar{i}* (maskhuj), *ku η \bar{u}* (qytet) *kungu \bar{i}* (Malësi), *hama \bar{i}* , *çaka \bar{i}* , Φ \bar{i} , por edhe: *ija*, Φ *je* (yje).

Disa emra e formojnë shumësin duke marrë mbaresën *e*: *vorre*, *male*, *katune*, *gardhe*, *gjyshe*, *kurbane*, *malhere*, *sebeta* dhe *oxhaqe* (në këtë të fundit kemi edhe një shenjë të dytë, është palatalizuar bashkëtingëlloren grykore me të cilën mbaron fjala).

Vërehet se me anë të zgjatimit të zanores të rrokjes fundore të temës e

formojnë trajtën e shumsit pothuajse kryesisht emrat që mbarojnë në njëjës me bashkëtingëlloret *k* ose *r* (zgjatimi është shkaktuar nga rënja e mbaresës së që kanë marrë): *dināk, baxhanāk, zdërvëk, bërzhik, jastak, çekrik, pëtuk, katunār, litār, kulār, çerën, qën, mēzatūr.*

Disa e formojnë shumësin si kudo duke palatalizuar bashkëtingëlloren grykore fundore: *fiq, uq, bulq, truq.*

Disa të tjerë e formojnë duke u metafonizuar zanorja e temës: *djel; mzet; qē* dhe *decën* (tek e fundit si shenjë e dytë është edhe mbaresa *ën*).

Në mënyrë të parregullt e formojnë shumësin emrat:

— *kren* (krye) *kΛl* (kal), *shytën* (shat), *thās* (thes).

Siç pamë, disa emra kanë paralelisht dy forma të shumësit, kështu gjejme aty: *gjysha* dhe *gjyshe*, *gardhna* dhe *gardhe*, *la^oma* dhe *la^omna*, *prroi* dhe *prroi^ona*, *decna* dhe *decën*, *pōlla* dhe *pōllna*, gjithashtu nga njëra anë *hamaj*; *çakaj*, dhe nga ana tjetër: *bakalla*, *maḡalla*.

Rasat — Emrat mashkullorë të trajtës së shquar numuri njëjës që mbarojnë me zanore e formojnë trajtën e kallëzores duke e marrë mbaresë-nyjen *n* (ë) drejt për së drejti pas temës: *barīn, sōn, dhën trān, kān, krūn, thun, kushr3¹n*. Emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore e formojnë duke marrë edhe një zanore i ose u ndërmjet temës dhe mbaresës: *grunin, dētin, tā^omlin, dashin, qēmnin, gishtin, ahin, m3¹kun, kadillëkun, zdërvekun*; në këtë mënyrë e formojnë shpeshherë kallëzoren edhe ata emra që sot mbarojnë në të pashquarën me zanore, por që dikur kanë mbaruar me bashkëtingëlloren *n*: *ml3¹nin ull3¹nin*.

Si në të gjitha të folmet e tjera të Shqipërisë së Mesme edhe këtu ekziston një trajtë e veçantë e së ashtuquajturës rasë vendore: *nuk ap gu^ooc n rakit; e zējshim n djept; a^o tu kalu m ha'et; a kshtu, për qefit tat?! e kam venū për g^uoc^oç filā^onit; ne Luma merret me Mirditët; ka bā^o asqerllëk m Turkiët; i mshā^om me msh3¹sēt*. Emri i shoqëruar me parafjalë që kërkojnë vendoren, kur është në një togfjalësh me një atribut (një mbiemër i nyjshëm ose një emër në rasën gjindore), del më shpesh në kallëzore të pashquar: *n buz t krahit, n shtuf t krahit; n breg t prroit; Malsi Krue i thon n Zall t Mnerit e n Breg t Mates; me bisht sPut.*

Si në Malësi edhe në qytet, më të rrallë konstatohen raste ku shihet se emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore nuk e nxjerrin *v*-në antihiatizuese në formën e rasës gjindore-dhanore shumë: *e miqet, e shoket, t katunaret, m krPt pes dite; e duret mia*.

Herëherë, sidomos më tepër në qytet, në formën e rasës gjindore-dhanore shumë reduktohet fare zanorja që kanë emrat si mbaresë në emërore: *g^uocvet* (gocavet), *rr^uobvet* (rrobavet), *e burrvet* (e burravet), *atynve konve t vogla; prij msimve, e shkollvet tona*.

Për rrjedhoren e pashquar të numrit shumë krahas formës së re me mbaresën *ve*, ekziston edhe forma e vjetër me mbaresën *sh*: *faqe burrash; faqe gocash; brac pulash; kena pas lujt arrash; prij lagjesh t tjera; e mante për krahësh; për shkallsh*.

Përemrat

Vetorët, dëftorët. — Përemri vetor i vetës së parë të numrit njëjës del shpesh herë me trajtën *un*, por rrallë hasen edhe trajtat *u, une*. Përemri i vetës së parë shumë ka rregullisht trajtën *na*.

Përemrat dëftorë numur njëjës të gjinisë mashkullore e femërore në rasën emërore kanë trajtat: *ai, ajo, ky, kjo*, ndërsa në kallëzore kanë trajtat *atā^o* (ai, ajo), dhe *ktā^o* (ky, kjo).

Pronorët. — Si në të gjitha të folmet *gege*, edhe këtu ekzistojnë përemrat pronorë vetvetorë: *ja bleu nipi vet; ai ka t vetin; hem ke t vet e djalit, hem ke t vet e nëses.*

Përemrat pronorë kanë pothuaj po ato trajta që kanë edhe në të folmet e tjera të gegërishtes jugore. Në Malësi duken edhe trajta që janë karakteristike për të folmet më veriore të gegërishtes dhe kjo shpjegohet me vetë pozitën gjeografike të asaj zone.

Sa herë që pronorët përdoren si përemra, kudo janë të nyjzuar: *i imi, e imja, i joti, e jotja, të mit, t mijat, t tujt, t tujat.*

Duke përjashtuar përemrin e vetës së parë kur prona është shumës dhe pronari njëjës, pronorët, kur janë në funksion të mbiemrave, dalin gjithmonë të panyjzuar, sidomos kjo në qytetin e Krujës.

Prona njëjës pronari njëjës

Veta e parë

gishti *im*
i gishtit *tëm*
gishtin *tëm*

dora *ime*
i dorës *tëme*
dorën *tëme*

Veta e dytë

gishti *jot*

i gishtit *tat* (Kru.) *tá^on* (Malësi.)
gishtin *tat* (Kru.) *tá^on* (Malësi. e Kru.)

dora *jote*

e dorës *tate* (Kru.), *tá^one* (Malësi)
dorën *tate* (Kru.), *tá^one* (Malësi)

Prona shumës pronari njëjës

Veta e parë

djelt e *mī*
e djelmet *mi*.

gocat e *mija* (herëherë edhe: e *mī¹a*)
e gocavet *mija* (herëherë edhe: *mī¹a*).

Veta e dytë

djelt *tūj* (Kru.) e *tuj* (Malësi)
djelmet *tuj*

gocat *tuja* (Kru.), e *tuja* (Malësi)
gocvet *tuja*

Prona njëjës pronari shumës

Veta e parë

katuni *jōn*
e katunit *tōn*
katunin *tōn*

shkolla *jōn*
i shkollës *tōn*
shkollën *tōn*.

Veta e dytë

kali *juj*
e kalit *juj* (Kr.), *tuj* (Malësi)
kalin *tuj*

lopa e *juj*
e lopës *juj* (Kru.): *tuj* (Malësi)
lopën *tuj*

Prona shumë pronari shumë

Veta e parë

kAlt tá^on
kAlet tá^on

lopët tona
e lopvet tona

Veta e dytë

kAlt tuj

lopët e tuja

Këto të folme së bashku me të folmet e tjera të gegërishtes jugore e kanë të njëjtë me toskërishten trajtën e emroses të pronorit veta e parë kur prona dhe pronari janë njëjës: *gishti im, dora ime*.

Trajta e vetës së dytë njëjës mashkullore *gishti jot* është një shtrirje e trajtës së femërorit (*jote*) pa mbaresën e gjinisë femërore.

Trajtat e rasave të zhdrejta të po këtij pronori, siç shihet, nuk janë të njëjta për qytetin dhe Malësinë. Në qytet janë trajtat *tat* për mashkullorin dhe *tate* për femërorin, ashtu si në të folmet jugore të gegërishtes, kurse në Malësi janë trajtat *tá^on* për mashkullorin dhe *tá^one* për femërorin, ashtu si në të folmet më vetiore të gegërishtes. Kjo, siç thamë, shpjegohet në faktin se Malësia ndodhet më në veri, më afër zonave veriore të Gegërisë.

Trajta *tūj* e pronorit kur prona është shumë dhe pronari njëjës është barazuar me trajtën e rasave të zhdrejta të vetës së dytë kur prona dhe pronari janë shumë. Ky fenomen vërehet në shumë të folme veriore.

Pronori i vetës së dytë në rasën emrore kur prona është shumë dhe pronari njëjës ose shumë në qytet del pa nyje, kurse në Malësi, përkundrazi, del me nyje, ashtu si në shumë të folme geqe më veriore.

Pronori i vetës së parë kur prona është njëjës dhe pronari shumë ka trajtë të njëjtë si për femëroren edhe për mashkulloren: katuni *jōn*, shkolla *jōn*, del e qartë se këtu kemi shtrirjen e femërores për mashkulloren.

Të pakufishëm. — Po përmendim disa nga përemrat e pakufishëm, të cilët, megjithëse nuk janë krejt të veçantë për këtë të folme, prapsepap kanë një interes për krahasimin e të folmeve të gjuhës sonë:

kush: *s mun t përçete kush // s á^o tu majt kush tre luop'*

do ose varjanti tjetër fonetik **da:** *do toka sh^hsh // do kana^oqe // da lush pri fushë // shoqja (=tjetra): tërhek niá^ona shōqen // dokushdo: pse po i vishite dokushdo ata?! qikto: i kena pas gjithmon me qikcosh // disa, dikush, secili, gjithseca'lli.*

F O L J A

Dëftorja

E tashmja: Foljet ndihmëtare "jam", "kam" dhe folja "them" në vetën e parë të shumësit mënyra dëftore koha e tashme dalin më shpesh me mbaresën *na: jena, kena, thona* (herëherë edhe me zanoren e temës të palatalizuar më tej: *ina* ose *jina, kina*; trajtat e mbarë shqipes me mbaresën *mi: jemi* ose *imi* dhe kemi janë më të rralla në këtë të folme.

Tema e foljeve të zgjedhimit të dytë klasa e parë në vetën e parë njëjës dhe në tri vetat e shumësit mbaron me *s: fus, kullos, shkis* (shqit), *tûs* (tunt, tund), *kullosim*.

Foljet e zgjedhimit të tretë në vetën e parë të numrit njëjës mbarojnë me *j*: *shkoj*, *pnoj*, *fërroj*, *thaj*, *vrej*, etj. Në vetën e dytë dhe në vetën e tretë njëjës këto folje dalin fare pa mbaresë vetore: *maro* (mbaron), *pno* (punon), *lavdro* (lavdëron), *thΦ* (thyen), *rū* (ruan), *lū* (luan), *vje* (vjen), *l'e* (len).

Foljet pësore në vetën e parë shumës kanë mbaresën *-na* (shumë rrallë hassen forma me mbaresën *ena*, (*h*) *ena*): *lodhna*, *mirna*, *vretna*, *nifna*, (njihemi), *lana*, *xarrōna*, *zīna*. (zihemi). Në vetën e dytë shumës kanë mbaresën *ni*, por herëherë edhe mbaresën (*h*)*i*: *lodhni*, *vrētni*, *la^hni* dhe: *zi^hi*, *xarro^hi*.

E pakryera: Forma e vetës së parë numri njëjës e foljeve veprorë në qytet formohet më tepër me mbaresën *-shem*, *-jshem*, kurse në Malësi formohet me mbaresën *she*, *jshe*: *ishem*, *shifshem*, *qepshem*, *mifshem*, *nifshem*, *grishem*, *punojshem* (Kru) dhe: *kishe*, *pnoshe*, *rūjshe*, *kthejshe* (Malësi).

Në të gjithë zonën për vetën e dytë njëjës foljet me bashkëtingëllore kanë një formë të vetme, atë me mbaresën *-she*, ndërsa ato me zanore kanë dy forma që përdoren paralelisht, një me *-jshe* dhe një tjetër me *-she* (më e përhapur është forma me mbaresën *-jshe*): *kishe*, *lajshe*, *lujshe*, *shkōshe*, *pnōshe*, etj.

Veta e tretë njëjës e foljeve më bashkëtingëllore ka një formë të vetme dhe të përbashkët për të gjithë zonën, atë me mbaresën *te*: *nepte*, *hjekte*, *huthite*, *thirte*, *shifte*, *kishte*, *ishte*, kurse ajo e foljeve me zanore ka disa forma, dy në qytet dhe tri në Malësi: në qytet ekzistojnë format me *nte* dhe me *te* që kanë pothuaj përhapje të barabartë ndërsa në Malësi gjejmë: një me mbaresën *jte* që është më e përhapur, një tjetër me mbaresën *te* më pak të përhapur dhe një me *nte* që haset fort rrallë: *late*, *bā^ote*, *vrēte*, *hā^onte*, *man^ote*, *çante*, (qytet): *vrēj^ote*, *luj^ote*, *bij^ote*, *msoj^ote*, *msoj^ote* majte, *qellote*, *kërkote*, *dote*, *shkote*, *vite*, *bite*, *takote*; *bā^onte*, *gj^onte* (Malësi).

Format e shumësit janë ato të mbarë gegërsishtes, d.m.th. veta e parë me mbaresën *shim* / *jshim*, veta e dytë me *shit* / *jshit* dhe veta e tretë me *shun* / *jshin*: I. — *qepshim*, *futshim*, *nepshim*, *shkojshim*, *dojshim*, *lujshim*; II. — *qepshit*, *vrē^oshit*, *shkojshit*, *lujshit* III. — *mshtellshin*, *vjetshin*, *qitshin*, *ngjojshin*, *bā^ojshin*, *tojshin*

E pakryera e foljeve pësore nuk formohet këtu duke i ngjitur temës së foljes mbaresat e veçanta që tregojnë diatezën pësore (si: *lodhesha*, *lahesha*, etj.), por duke u venë përpara pjesëzën përemrore u formave të së pakryerës së foljeve veprorë: *u lodhshe*, *u lajshe*, *u përdorte*, *u huthite*, *u fote*, *u ftillonte*, *u tristojte*, *u tremshim*, *u lajshim*, *u lajshit*, *u merrshit*, *u zë^oshit*, *u merrshin*.

E kryera e thjeshtë. — Ndryshe nga të folmet më jugore të Shqipërisë së Mesme, këtu haset shumë rrallë forma e aoristit sigmatik: *u lothsh* (u lodha). Më e rëndomta është forma asigmatike: *u zuna*, *u xërrova*, *u lodha*, etj.

Si foljet *bā^ona*, *hyna*, në të cilat ruhet tema e vjetër me *n*, dalin këtu edhe disa folje të tjera të zgjedhimit të tretë: *bēsht^ona*, (bështyva), *lyna* (lyeva), *gdhina* (gëdhiva), *meni* (meu = shterroi).

Pothuaj gjithë foljet e zgjedhimit të parë që e bëjnë aoristin me apofoni dalin pa mbaresë në vetën e tretë njëjës: *sūll*, *dūll*, *mūr*, *mshtūll*, *dogj*.

Nuk kanë mbaresë vetore në formën e vetës së tretë njëjës të aoristit edhe disa folje të tjera: foljet e zgjedhimit të katërt klasa e dytë që në të folme të tjera nxjerrin *n* (r-) e temës, si: *pru*, *zu*, *vu*: di sa nga foljet e parregullta: *pat*, *erdh*, *hā^ogër* dhe foljet: *gjet*, *met* (mbeti).

Forma të kohës së shkuar të foljeve pësore. — Në qytetin e Krujës u vërejt se format e përbëra të së kaluarës të foljeve pësore formohen nga format e foljeve veprorë duke u paravenë këtyre pjesëzën përemrore *u*: *u ka bā^o*; *u ka vra vōn*; *u ka zmadhū*; *u ka marū shpē^oni*; *kur u pat vrā*.

Perfekt i dytë dhe pluskuamperfekt i dytë. — Në Krujë dhe në Malësi, ashtu si në të folmet e tjera geqe, ekzistojnë trajtat e perfektit dhe të pluskuamperfektit të dytë: *kam pas vū, kam pas lā°n, ka pas humat, e ka pas zā°n turpi, kena pas lujt arrash, kena pas l'ē, kina pas përdor, kan pas vesh, kan pas vjedh, kan pas lā°n* dhe: *kishte pas dhā°n, kishte pa pas, kishin pas hā°k*.

E ardhëshmjia.—Forma e së ardhëshmes e përbërë prej pjesëzës *do* + lidhore ndeshet shumë rrallë këtu: *goc do t'i thom n'er ke t vdesi*; për të treguar veprimin që kryhet në të ardhëshmen përdorin më tepër togun e përbërë prej foljes "kam", prej parafjalës "për" dhe prej emrit foljor asnjanes të pasquar: *s'kam për ta shkull; ke për t shku m Krū sone; sun ke për ta kap; i buk ka për t gatu ajo; s kena për t shku kurkuni*.

Lidhorja

Foljet e zgjedhimit të parë, të dytë dhe ato të zgjedhimit të katërt klasa e parë e formojnë lidhoren e kohës së tashme veta e dytë njëjës me mbaresën *sh*, kurse ato të zgjedhimit të tretë e formojnë me mbaresën *jsh*: a) *të marrsh, t'i futsh, t kesh, t dūsh, t kesh, t rr'ash*; b) *ta prnojsh, t ç'ajsh, t pshojsh, ta shajsh, ta majsh, t rujsh, t lëjsh, t flëjsh*.

Forma e vetës së tretë njëjës e foljeve që u mbaron tema me bashkëtingëllore zakonisht ka mbaresën *i*, ndërsa ajo e foljeve që u mbaron tema me zanore ka mbaresën *j*: a) *t qasi, t vdesi, t'i fusi, t pjelli*; b) *t'i lshoj, ta pshoj, t shkoj, t bā°j, t'i zā°j; t vij, i rr'aj*. Në Cudhin (katund i Malësisë) kemi hasur edhe njady raste me mbaresë *e* nga foljet me temë në zanore: *t vie, t'mi shikoe* (krh. mbaresën *ē*). Herëherë foljet me bashkëtingëllore dalin edhe pa mbaresë: *t'i kullos, t gas* (këto duket të kenë pasur *ē* e cila është reduktuar dhe nuk ndihet sot në fund të fjalës).

Paskajorja

Si paskajore, ajo që ka një përdorim më të madh, është trajta e mbarë gegërishtes, ajo që është e përbërë nga pjesëza *me* dhe nga forma e pjesores së foljeve. E ashtuquajtura paskajore toske *për+emër foljor asnjanes i pasquar* në krahasim me të parën haset shumë pak (në qytet përdoret më shumë se në Malësi): *kam nevoj me pnu; ti ço zoti me t provū; me t rā ni plum ktu, maro; se s't'ep gjā°ja tā°mël po s pate gjā° m'i dhā°n me hā°ngër*; dhe: *për t qit s'e kina pas zakon me qit, s'kam për ta shkull; i buk ka për t gatu ajo, ç'ka ajo?! sun ke për ta kap, s'kena për t shkoū kurkuni, paç për t shkoū atje n maqint; qirosi (është) për t'i ra lules kres mā°!*

Pjesorja

Duke përjashtuar disa folje të parregullta e gjysmë të rregullta, edhe këtu sot pjesorja e trajtave të përbëra foljore është pa mbaresë: *hap, rraf, vdek, thurr, p'p't, mshtjell, përcjell, lujt, rujt, njëjt, majt, ardh, pas, dash thē* (thyer). *bëshū, plagū, bā°, pī, pā, blē, zī, dā, xē*. Pa mbaresë dalin edhe dy folje nga të zgjedhimit të katërt kl. e dytë: *rā, vū* (herëherë në të folme geqe këto i gjejmë me mbaresë: *rām, vūm*). Foljet e tjera të parregullta e gjysmë të rregullta kanë *n(ē)*: *zā°n, dhā°n, thā°n, lā°n, qën* — vetëm fojla e parregullt "ha" del në pjesore me formën: *hā°ñerr* (qytet), *hā°gërr* (Malësi). Tek

mbiemrat foljorë pjesorja del me mbaresat *un* (foljet me bashkëting.) dhe *m* (foljet me zanore): *i papjekun, i vdekun, i përzim, e përzime, e venume, e pamartume.*

Toğu foljor "jam" + përciellore. — Trajta foljore me pjesëzën *po* që e kufizon të zgjaturit e veprimin të foljes brenda një kohe të dhënë (*po punoj, po punonte*) përdoret shumë rrallë, për të mos thënë se nuk haset fare. Si ekuivalente të kësaj trajte këtu gjejmë një tog foljor të përbërë nga trajtat e shtjella të foljes "*me genë*" dhe nga përciellorja e çfarëdo foljeje (*jam tui punu*). Ndërsa trajta e thjeshtë me pjesëzën *po* ka vetëm formën e së tashmes dhe të së pakryerës, ky tog foljor e jep veprimin e foljes në të tashmen dhe në të gjitha kohët e së kaluarës: *s'jam tui shpëf; s'jam tui nkū; jam tu mif; jam tu laf3t; je tu la faqet; je tu lujt nishānash; ka je tu shkū? tu pshu je ti, ma!; ā° tu u kull; sā° tu majt kush tre luop; ā° tu ra shi; jena tu bā° lafe, jan tu pshū; ishem tu fle3t; ishte tu hec.*

Kur toğu është folje kallëzues i një fjalie që vjen si përgjigje e një pyetjeje të bërë nga bashkëbiseduesi, folja ndihmëtare "*jam*" shpeshherë nuk del. Në këto raste kategoria e kohës dhe e vetës sqarohen nga konteksti, sidomos nga pyetja e bërë prej bashkëbiseduesit: sa vjeç je? — *vallai tu mush shtat-dh3tat* (jam) // Ç'farë po bën! — *tu msha1* (jam); po gëdhihet? — *tu gdhi* (ashtë)

Ndajfolje, parafjalë, lidhësa

Do të kufizohemi këtu duke dhënë ato ndajfolje, parafjalë e lidhësa që janë karakteristike për këtë të folme dhe për nëndialektin ku bën pjesë ajo.

Ndajf. vendi: *taposht* (tatëpjetë), *trama°*, *trama°l*, *tërma°*, (përpjetë), *gjithanej* (kudo), *përpari* (më përpara), *njat* (afër: *s'kam qen njat me ket dreq*), *gitu* (ja, këtu), *kā°* (nga), *ka ose qikha* (këtej), *tjetërkun* (gjetkë), *tu* (=këtu), *mrpa, tutjē ose tutē, përtej-përtejna, përtē, atej, knejta.*

Ndajf. kohe: *mrā°ma* (=sot në mbramje), *mrā°m*, *dje-mrā°ma*, *pardje-mrā°ma* ose *parmrā°mi*, *pardie1*, *qetërpardiēj*, *matere*, *majjyna*, *masanaj* dhe *kahā°ne* (=ka kaluar një kohë, lasht), *përmot* (=mot).

Parafjalë: *prij* (*prij s'stofiti; prij f3'si*); *m* (ë) që përdoret shumë këtu edhe për marrëdhënien vendore (*a tu kalu m ha1et; e mūr ni goc m Krū; m kohe qi ka qen kjo n'e m dymdhet vjeç*); gjendet këtu me një përdorim të madh varianti verior *ke* i parafjalës *tek* (*i rādhi ke u e i rādhi ke ti; ke shp3ta ime*).

Lidhëza: *ne, ene* (=dhe, edhe): *ne z1gjt e ngjojshin; se t1nz shahet ne mreti; jan ne t ligta fort; t ap ne dashin e ça e shko! u s mū ne vdiq ma: ene vdekjen e kina; atΦ ene përtejna i thon Bën;*

n'er, n'e (=gjjer dhe gjersa): *n'er ke kalaja, n'e m dymdhet vjeç; n'e ke pazari; goc do t'i thom n'er ke t vdesi ajo; n'e ke t sjelli;*

se (=qyshse, qëkur, qëse): *s'e ka hi kjo parti, s'kam qën; ai se ka lē, përka pun me dōr s'ka.*

FJALËFORMIMI

(Si në shumë të folme të Shqipërisë së Mesme dhe këtu është karakteristik formimi i emrave të veprimin me anë të substantivimit të mbiemrave foljorë të gjinisë femërore: *e enme-e enmja; e mshtjellme — e mshtjellmja, e shlumje — e shlumja, e lujtme — e lujtmja, e majtme — e majtmja, e ngjumje — e ngjumja, e kapme — e kapmja, e lidhme — e lidhmja, e hikme — e hikmja, e bërt3tme — e bërt3tmja, e gërt3tme — e gërth3tmja.*

Emra veprimi të ardhur nga fjolet formohen edhe me prapashtesat *je,*

im, porse numri i këtyre është shumë më i vogël në krahasim me të parët: *vdekja*, *vujtje*, *mushje*, *fitim*, *mallkaim*, *lâ°ηz3'm*. Prallë këtu hasen edhe emra veprimi të ardhur nga pjesorja pa prapashtesa *grin-a* (grindje), *trëm-a* (të tremburit, frika). Prapashtesa *th* përdoret për formim emrash me kuptim zvogëlimi: *urith*, *zekth*, *hith*, *gjutha*, *shfrethe sahâ°nash*.

Me prapashtesën *e* formohen emra bagëtitsh të gjinisë femërore. Zakonisht këta formohen nga emrat e gjinisë mashkullore: *bardhoke*, *ka°ce*, *korbe*, *kuqe*, *lule*, *shterre*, *brisjape*, *kâ°mlarme*, *krç kuqe*.

Nga fjalët e përbëra, përveç kompozitave të mirëfillta si: *brisjape*, *kâ°mlarme*, *krçkuqe*, *larzi*, duhen nënë në dukje edhe fjalë të formuara nga një përngjitje, e shkaktuar nga të qenët e fjalëve pranë njera tjetrës brenda një fjalie: *paderma°n* (domosdo), *kaha°ne* (ka shumë kohë), *farzana°ti* (asgjë), *përnot* (mot), *qitu* (ja, këtu), *qih°tâ°* (ja, këtej), *tefû* (që andej tëhu), *pardje-mrâ°mi*, *djemrâ°ma*, *qetëpardiei*.

LEKSIKU

Sigurisht që, si çdo e folme tjetër, edhe kjo paraqet një interes për leksikon e saj dialektor.

Nga njera anë aty shihen fjalë të përbashkëta të dialektit verior, të cilat ose kanë një shtrirje në të gjithë veriun ose të paktën në pjesën më të madhe të veriut, e sidomos në ato që ndodhen nga Kruja e sipër; shihen pastaj fjalë dialektore që janë të përbashkëta për të folmet e Shqipërisë së Mesme (për të gjitha ose për pjesën më të madhe) dhe më në fund dallohen fjalë të veçanta që kanë një shtrirje më të ngushtë territoriale: në Krujë e në Malësi të Krujës dhe në zona që janë pranë saj, si Mati a ndonjë tjetër.

Edhe leksiku i disa sferave të veçanta që është i lidhur me karakterin e ekonomisë së zonës, si ato të sferave të bujqësisë, të blegtorisë, të endjes së pëlhurës dhe të mullirit, e karakterizojnë këtë të folme nga pikëpamja dialektore.

Fjalët e kategorisë së parë (dialektore të përgjithëshme), po i japim këtu në formë të një liste duke i ndarë në grupe, kurse ato të kategorisë së dytë do t'i japim në formë të një fjalorthi të ndara sipas sferave.

I. *Fjalë të gegërishtes: akllái* (= peci), *ashkël—ashkla* (= bujashkë), (M, Kruj.), *bërzhik-u* (Kru.) dhe *përzhik-u* (M.Kru.), *buç-a* (përparëse grash), *bukël-bukla* (nuslala), *cek* (jo thell), *cugal-i*, (=tra në çati, prift, baballëk), *dac-i* (maçok), *dajak*, *dajre*, *faqe* (= në prani) *fërgoj*, *ftere*, *gurr-gurra*, dhe *tâ°m* — *tâ°ma* (=burim), *hallakat* (=përndaj), *heret* (=shpejt), *hüt - huta* (=shpend i madh me pendë dhe sy të keq), *huta°ni* (=bufi), *katec-i* (koshar misri), *katun-i*, *katunar*, *kavall-i* (=fyell), *kërkoj* (=kaloj nëpër vende të ndryshme, bredh), *komshija*, *kurkuni* (=asgjëkund), *lvore-lvorja* (1. = lëkura e pumës. 2. cipa e vezës), *mâ°gje-mâ°gja* (=govatë), *mrâ°më* (=sonte në mramje *mrrâ°n-i* (=erë veriu), *niall* (=shëndosh), *nijat* (afër, pranë), *petke-t* (rrobë), *përkun* (=tund, kolovit), *përzë* (dëboj), *qes* (hedh posht), *sall* (=vetëm), *saxhak-u* (perusti, skile), *strajc-strajca* (=trastë torbë), *shkqs-shkosi* (lajmës) dhe *krushqar-i* (Krujë), *shplaka e dorës* (pëllëmba), *shputa e kâ°mës* (=putra e këmbës), *tef krahi* (=supi i krahut) edhe *shtuf krahi* (M. Krujës), *ter* (=thaj), *tinz* (=fshehurazi), *unyr-unyra* (=lyrë), *vrej* (=ruaj).

Fjalë të gegërishtes jugore. — *çap-çapa* (=kafshitë), *dallap-i* (=dritare), *dallap gorr* (=kamare), *dru* (=ndoshta), *dufëm* (=zagushi), *dum* (=sun po i jap dum = s'po i bëj dot ball), *faqore* (=shishe rakie e vogël), *fërnët* ose *lâ°gz3'm-a* (=lagështi, igrasi), *gëlvoşk-a* (gollovezhgë), *goc - goca* (=vajzë), *gjel deti*, *gjëroj* (=ligjëroj), *gjithheret* (=kurdo), *kaçile* (=shportë), *kallaj-a* (kuti

teneqeje), *karthje* (=shkarpa), *kashtis* (=përziej), *katro^{ve}* (=shtëmbë), *kërnac* (=dorështrënguar), *laf³i* (=ngatëroj mendimin), *i*, e *ligët* (= i, e dobëbët), *ligat* — *ligata* (= sëmundje), *llokm-a* (=thelë mishi), *men* (=pushon, shteron çesma), *mjer* (=deri), *mrel-a* (=mizë e madhe në bojë të mjaltit që ngacmon qetë, kuajt), *padermâⁿ* (=patjetër, domosdo), *i parllik-u* (=drejtimi i punëve dhe i ekonomisë së shtepisë), *përmot* (=mot), *sefere* (=pjatë), *qūr-quri* (qilar), *sjell* (qëlloj, shtie), *shpërgâni* (=shpargër), *sht^p-a* (leckë që përdoret për të larë enët dhe dyshemetë), *taposht* ose *trapo* (=posht, tat-pjetë), *tef-i* (majë, maja e mprehtë e brisikut), *te^u* (=tëhu, tejt), *tramâ^ol* ose *iërmâ^o* (=përpjetë), *trap-i* (=mezhdë), *ukth-i* (tra çatie, trari i mesit që shkon për së gjati), *vâl* (=i nxehtë), *vdōr-vdora* (=dëborë), *zabel-i* (=pyll i vogël), *zar-i* (=zagar).

Fjalë të veçanta të zonës. — *avull-i* (= të nxehtit), *bakom-a* (=boganik), *bartor-i* (=qeraxhiu që transportonte mallrat e tregëtarëve), *bërs³j* (=thërmoj, bëj copë copë), *bërthokël*, *thokël* (Mafsh. (=bërthamë), *bishtur-i* (=mahia e çatisë), *brushtull-i* (=pispilitë), *b^othse* (=pelenë leshi), *dorâr-i* (=dorësi, ai që ka bërë vrasjen), *fali* (dielli) (=perëndoi dielli), *flit^a-ja*, (=përshesh me bukë misri i përvëlur me gjalpë), *galaçep* (=kaliqaf), *garmohem* (=gremisem), *gore-gorja* (=kone), *gjymës-gjymsa* (shami koke që lidhin plakat), *kori* (=reciprok), *me kōrez* (=reciprokisht), *ksul* rrethake ose *qelege* (=qylaf shyt), *ksul me māj* (=qylaf me maj), *lush* ose *lushaⁱâⁿ* (=fusharak), *lym-i* (=llumi që le lumi), *llajt-a* (=dërrasa me të cilat thurrrin oborrin), *malihâ^one* (=malësore), *mathvëshat* (=veshmbathjet), *met* (=gllënkqë), *nërmjeltâr-i* (ndërmjetës), *niel-a* (=pjesa e sipërme e krahut të pulës), *nr^Λj* (=zgjidh fëmijën dhe i ndërtoj rrobat), *peçe-peçja* (=shami koke prej pambuku), *i përjashmi* (=i huaj, jabanxhi), *plaçkadis* (=plaçkis), *popçi* (=këpucar), *i prap* (=i vështirë: *vëne t prapa*) *proshk-a* (=korie), *qez-i* (=qeth, jastagaç), *qimasre* (=dizgë, çimboskë), *rreshmet-t* (=rozga), *sak* (=tamam, mirë: *e din sak*), *sjuk-a* (kllōçka), *sharâ^on-a* (=lerë gurësh në mal), *sheshijoll-i* (rrugë publike e gjerë), *shkr^oth* (shpij), *shkullōi-a* (=një copë hëkur i kthyer në njëren anë, përdoret për të trazuar prushin e zjarrit), *shtre^{the} sahâ^onash* (=raft pjatash), *sh^ol-a* (=fundi i shtëmbës që mbetet mbaşi thyhet, përdoret për t'u dhënë ujë pulave), *tajër-i* (Noe) (=qeth, jastagaç), *trēm-a* (=frika), *thagall-i* (=fëngjilli), *ukth-i* (=tra çatie, trari i mezit që shkon për së gjati), *ulurâⁱ-a* (=kope ujqish), *vegël-vegla* (=avlëmëndi), *vënâr-i* (=vendës), *vën* e *raki* (Noe) (ylberi), *vrânga* (=shenjë plage në kokë), *xhâⁱ J^oaxh-a* (vëllai i babit), *zhglyhem* (=ndotem).

Fjalë të gegërishtes veriore: *cof* (ngordh), *çikon* (=pikon), *fkas* (=thërras), *ftilloj* (=zhvilloj), *grāt-grata* (=forcë, efekt: *ka m̄ shum grāt toka*), *gjiltanej* (=kudo), *hollshëm* (=hollë nga shëndeti, nga pasuria), *kaish-i* (=rryp), *kumare-kumarja* (=nuni, kumtri, kumbari), *marrohem* (=turpërohem), *nevaj-a* (=ngarkaçe), *përmot* (=mot), *qes* (=hedh, shtie), *shëg-shega* (shekë, kadishte), *shejtū* (=me plagos), *shij* (=thërmoj, shkoq).

Fjalë nga sfera e bujqësisë

ān-ana = ana e arës; ovratë.

arape-arapja = tokë e dobët, tokë që nuk jep prodhim.

babune-babunja = masë drithi e njëjtë me 10 kg.

bār-barra = masë drithi e njëjtë me 160 kg.

bīm -bima = bima e misrit e parritur; bitër.

bōç misri = fletët që mbështjellin kallirin e misrit. Në Mafsh. i thonë *gzhalla* e *kall³nit*.

(me) *copū* = të coptosh tokën me kasëm ose me shatë.

çel djerr = hap tokë të re, hap rrah.

çimk-çimka = xinxife, ide, mërçinjë.

çoj = punimi i parë që i bëhet tokës.

djerr-i = tokë lëndinë.

d'orz kashte = dorëz lëpushkash misri. Në Cudhi dhe në Krujë i thonë: *kraha-t*.

erze-t = barishte me erë që përdoren për gjellë.

ftil-i = vllastar ulliri ose i çdo peme tjetër.

gas (qiēt) = lëroj me qe.

garroqe-garroqja = zgjua blete.

ha°rr-a = bima e vogël e misrit që shkulet gjatë harrjes.

h°edhe-t = bëzhdilet që ngre era kur hedhin misrin në veri.

himt/∧j = shkrif tokën me shatë, thërmoj tokën.

jëmës-a = masë drithi e njëjtë me 20 kg. Në Krujë: *ujëms*.

kaçarrum-i = misrishte, koçan. Në Cudhi i thonë: *lalla'sht-a*.

kaçuqe = i thonë ullirit kur është me degë të dendura.

kalem-i = sythi i shartesës.

kall^{3t} misri = kallëp misri.

kāp-kapa = kapule, nuskëz lëpushkash misri.

kāsht-kashta = bima e misrit pa kallirin.

katec-i = koshar, grazhdar misri.

kij (ull^{3t}) = krasit ullinjt: *a tu ki ull^{3t}*.

klōt-klloa = tokë jo pjellore, kjo lidhet livadh për kullotë.

krah-i = degë ulliri e madhe.

krā°n-i = 1) sythi që del aty ku fillon bishti i gjethes së ullirit

2) endëza e ullirit.

krāsht-krashta (Kru.) = 1) mustaqet e misrit; 2) rrënjët e preshit. Në Mafsh-

mustaqes së misrit i thonë: *perça-t*. Në Cudhi i thonë: *musteqja*

e *kall^{3t}nit*.

krenaje arës = kreu i arës.


kihej ose përzi = i bëj punimin e dytë tokës. Në Cudhi: *pkut*.

lule-lulja = endëza e rrushit.

ma'f (mih) = prashit.

mja°l-a = fidan ulliri që e ndërrojnë për ta mbjellë.

parmën druni:




1. *vik-u*; 2) *sjapth* (Cudhi), *shpātlla* (Mafsh.) 3) *bishti dorës*; 4. *dorza*;
5) *veshas*; 6) *pūr-i*; 7) *qajka* (Mafsh.) *kulajka* (Cudhi).

pen-a = fleta e kashtës së misrit.

pres (misër) = korr misër.

pres-a = vija e arës që përdoret për vaditje.

- qásë-qásja* = masë drithi e njëjtë me 40 kg.
qeroj = xhvesh misër. Në Mafsh. i thonë: *zbardh.*
rihet = nxjerr degë të reja bima e ullirit.
shçemert \wedge *j* = shartoj.
shij = shkoq misër.
shlon bleta = kur bleta shtohet dhe nxjerr jashtë një pjesë të mizave.
shnik-u = masë drithi e njëjtë me 80 kg.
shpūr-shpuri = lehe gruri.
rrush vojguri = rrush me erë, rrush çeltik.
trān-trānā = vijë e hapur nga plori i parmendës.
tra'n-a = trinë, lesë.
trenoj = lesoj.
tōf-tōfa = xhufka e bimës së misrit.
ujš = vadis, ujit.
ullš'ni egrr = ullashtër.
uštē-ja = osteni.
vathoj = ngreh vathën e dhenve (vathë portative e përbërë me lesa të veçanta) për të plehëruar arën.
vec-i = kastravec, trangull.
vī-vīja = vijë e hapur me shatë ose me kazëm.
vllaje-vllaja ose *prije-prija* = oxhak kopështi.
zā° (q'et) = mbrej qetë.
zajraki ose *talk-a* = rrush kokërr gjatë, i bardhë ose i kuq.
zgjedh-a:



1. — kular-i; 2) hekrat e zgjedhës

Fjalë nga sfera e blegtorisë

- bai* = ka i larmë.
bardhok-u = dash me fytyrë të bardhë.
bardhoke-bardhokja = dele me fytyrë të bardhë.
berr-i 1) qengj; 2) një kokë bagëtie.
 (e) *bërdhukme* ose (e) *bërdhumët* (Mafsh.): dele e larme, me të kuqe e me të bardhë.
brisjape-brisjapja = dele që i ka brirët si të cjamin.
brīšk-brīška = dele me brirë.
brϕ me-brϕ mja = dhi me pulla të kuqe dhe të bardha.
daj qīngjat = keput qengjzat, zvjerdh.
dash-i kumonës = dashi që prin kopënë;
korp = dash i zi;
shjaz = dash me gushë të zezë.
dele = bagëti: *a° me dele.*
dzā°na e djathit (të zanë djathi) = një bukë djathi.
dhā°lule = dhi e kuqe ose e zezë me një njollë të bardhë në ballë.
faqezēz-faqezeza = dele me fytyrë të zezë.
fētϕ rkuq, e = dash, dele me fytyrë të kuqe.
gjini madh ose *gjini zi* = sëmundje që u prish sytë bagëtime.
gjiz-gjiza = gjizë.

ha'sk-u = ka me brirë të drejtë të ngritur përpjetë.

ha'sk-a = lopë me brirë të mëdhej.

hamür-i = dash ose cjan i patredhur.

hekrâ'q-i = sëmundje bagëtish, u prish sytë.

kâ°ce-ka°cja = dhi gjysëm e zezë e gjysëm e bardhë, ose tjetër ngjyrë

kâ°mlarme — *kâ°mlarmja* = dhi e kuqe me bark e këmbë të bardha.

kazi-u = ka i zi.

kec-i = (Kru, Mafsh.), *keç-i* (Cudh.) = kedh.

klloshëtër = *klloshira* = qumështi i parë i një bagëtie që posa ka pjellë.

kōk-koka (Kru.) = përdoret vetëm kur numurojnë krerët e bagëtive: *dhait,*
kōk dele.

korbe-korbja = dhi që është krejt e zezë.

corp-korbi = cjan që është krejt i zi.

krūt-kruta = dhi që i ka brirët të përkulur poshtë.

krΦkuqe-krΦkuqja = dele me krye të kuqe.

kuma°she-kuma°shja = dele e bardhë dhe e zezë.

kuqe-kuqja = lopë krejt e kuqe.

lār-i = dash dhe cjan me fytyrë të zezë.

bār-bara = dele me fytyrë të zezë.

lār-a ose *lōp e larme* (Mafsh.) = lopë e bardhë.

larkuq-i = cjan i bardhë me lara të kuqe.

larzēz-larzeza = dele e bardhë me lara të zeza.

larzi-u = cjan i bardhë me lara të zeza.

lkuq-i = ka i kuq.

lul-luli = ka dhe cjan me një larë të bardhë në ballë.

lule-lulja = lopë me një larë të bardhë në ballë.

luli kūq = cjan me lara të kuqe në ballë.

luli zi = cjan me larë të zezë në ballë.

llāshk (dele llāshk) (Cush. Mafsh.), *dhāshk* (Kru.) = delja që pjell para moshës së pjellorisë.

mera-meraja = kullotë.

merr lopa (ka) = mbarset lopa.

mēshjerr — *mēshjerra* = lopë e vogël 2-3 vjeçe.

mēzatūr-mēzatur = i vogli i lopës nga një vit deri sa bëhet ka.

mēzatore-mēzatorja = e vogla e lopës nga një vit deri sa bëhet lopë.

mēzat-i = kau i vogël 2-3 vjeç.

mtšni = përdorse druri në të cilën rrahin qumësht.

murg-murgji = ka i kuq me qafë të zezë.

murra e zēz = lopë krejt e zezë.

nej = passi e zjen, e le qumështin që të formojë ajkën.

nōll-a = vendi ku u japin kripë bagëtive.

pērdīn-pērdina = dhia që ka pjellë dy herë.

pētuk-u (m), *petuke* = ftujak, ftujake.

pjellak-u (=Cudhi) = kedh dy vjeçar.

qumēsht = hirrë djathi e përzjerë me qumësht.

rrjep (e) kuqe = dhi e kuqe me pak lesh.

rrūnx-rrūnxa = e vogla e deles kur është 2 vjeçe.

sjan vath = cjan më vëth.

strūg-struga = shkambi mbi të cilin ulen barinj të kur mjelin dhentë.

sΦkuqe-sokuqe = dele me sy të kuq.

shaz-shaza ose *ftyrkuqe* = dele me fytyrë të kuqe.

shāz-i = dash me fytyrë të zezë.

Deri Retu

shkopi mt³nit (Cudh) = rrotëza e tundësit. Në Krujë: *tuni mt³nit*. Në Mafsh *tunc-i*.

shterre-shterrja (Mafsh.) = lopë e vogël nga 1-3 vjeçe.

tá^omël-tá^omli = qumësht.

tredhak-u = çjapi i ziles, ai që prin dhinë.

varrose = dhi e zezë me vija kafe në fytyrë.

vá^oth = vëthët që ka çjapi në gushë.

vërnalc-a = hirra që del nga gjiza.

qilat = qeth delet vetëm në gushë, në bark dhe në bisht.

vísk-u (m.) *vísk-víska* (f.) = i vogli i gomares.

xhelek-u (m.) *xheleke-xhelekja* (f.) = i vogli i deles kur ka mbushur një vit.

zëk-zeka = dele e zezë.

zmil-i = ka me dy ngjyra.

Fjalë nga sfera e endjes së pëlhurës

allaxha = basme me vija, përdoret për këmbishë.

elenie-elenija = mjet me anën e të cilit heqin fijen e pambukut nga turra.

enc-enca = mjet me anën e të cilit bëhet mbushja e shumë gjepave njëkohësiht.

çekrik-u = mjet me anën e të cilit mbledhin fije me gjepa.



drug-druga = sovajka.

hent = veprimi që bëhet për thurjen e pëlhurës.: *jam tu hent plëhūr*.

kamrik-u ose *saje* = humai.


kavazllale (pëlhurë) = kur endja bëhet në mënyrë të atillë që pëlhura të dalë me kutija.

mas^ostre-ma^ostrja = gjepi i sovajkës.



1. rrotlle boshtit; 2) doreza e çekrikut; 3) shtresa, 4) gozhde çekrikut; 5) ká^oma.

mloj = veprimi që bëhet kur mbështillet hindi në shula: *â°tu mlû plêhur.*



1. *ml°s-mlesa*; 2) *kallâ°ma mlese*; 3) *goja e plêhurës*; 4. *shuli*; 5) *shkopi*-i
6) *ma°gje plêhure*.

(e) *mshtjellmja* (e *plêhurës*) = të mbledhurit e *plêhurës* në shul.


mushje-mushja = punimi i *plêhurës* në vegël.

na°p-na°pa = burulluk i bardhë.

pamuk-u = filli me të cilin mbushet gjepi i sovajkës.

përshkës-përshkesa = procesi i futjes së *plêhurës* në vegël.

vegël-vegli = tezgjah, avlëmend.



1. *kâ°mat e veglit*; 2. *varset*; 3. *truñqt*; 4) *shpatllat e tefes*; 5) *tesja*; 6) *shpat*; 7) *mallare*; 8) *liqt*; 9) *kamestra* (nalla°ne); 10) *shuli* (a. *shuli par*, *b*-*shuli mrap*); 11) *kallâ°ma*; 12) *shkopi shulit*; 13) *goja plêhurës*.

xhumar-i = kallami ku mbështillet fija e gjepit të sovajkës.

Mulliri

- b^ëcel-b^ëcela* = dru në formë bucele ku vendosen dërrasat e fletës.
dält-dälta = copë metali që përdoret për të shtrënguar shegzen.
flet-fleta = copa druri në formë lugu që janë vendosur me radhë në formë rrethi në bucelë; kjo rrotë e formuar me këto fletë vërtitet nga uji që bie prej lugut dhe ve në lëvizje gurët e mullirit.
kep-i = çekici që përdoret për të kalitur gurët e mullirit.
(më) hep (gurin) = të kalitësh gurin e mullirit.
k^uoshi = koshi i mullirit ku hidhet drithi.
kryq-i = dru në formë kryqi që vihet mbi gurin e mullirit.
lânz-a = lugu i vogël prej druri, i cili është i vendosur poshtë koshit, nëpër mjet saj derdhet pak nga pak drithi, që bluhet nga gurët.
lug-u = korita e mullirit.
mllar-i = hekuri që vendoset midis dy gurëve.
shage-shagja = një copë leckë që përdoret për të pastruar vendin ku grumbullohet mielli.
shegë-shegza = dru që vihet në mes gurit të mullirit, vendoset mbi kryq.
t³ηll³m-a = copë e vogël dërrase që është lidhur tek langza, ajo goditet nga guri dhe shkakton tronditjen e langzës dhe kjo bën që të derdhet drithi.
thys-thysi = guri që bluan drithin.

TEKST

- kpöc kan pas shkū prej Krūje e u shitshin n Tirā^on //
 Isuf Goci / ishte na^ot barā^omi / ishte tu shit kpöc // hasi me i krutā^on tjetër / i tha:
 — k[~] për t shkū m Krū sone?
 — p^u o //
 — pazh zotin / tha /. qe kta shtat gr[^]sh / tja apsh nā^ons t bā^oj harxhin për barā^om //
 ky e kër[^]k[^] tā^omn e Suf Gocit e sun e gjet // vojti ja dha Zā^onit Vilikā^onit (Kupaj) ¹⁾
 ky katër gr[^]sh ja dha / tre gr[^]sh i majti //
 erdh Isufi pri Tirā^one na^otën //
 — O nā^on / tha / e bā^one harxhin?
 — me se ta bā^oj harxhin / he bir? tha / katër grosh më ke çul tha: un t^o
 t kam çū shtat grosh / tha / o nā^on // kush ti ka prū?
 — paret / tha / mi ka dhā^on Zā^oni Vilikā^onit // t kam vū nā^ona / tha / gjymin m u lā //
 — nesër / tha / veç kur tëm lāj hoxha //
 futi tapā^onxhën n bres // kur dul / dul me bā^ot krejt // ky (Zā^oni) tu p^o
 p^o me shkadrā^on //
 — jun' a^otjeta juj / burra / e m gzo^ofshit barā^omin! t ndodhen me m i dhā^ona tre groshat / e Zā^on? se kur i kam fitū / i kam fitū me dy kām zbath //
 — siellu pazarit e ja e merri!
 ky u sull pazarit ene erdh //
 tha: — shpejt erdhe / se me ta fut i shjelm / tha / t hudh m Kavaçel ²⁾

1) Nga fisi i Kupit

2) Lagje e Krujës

- rr³i / tha / o Zâ°n / se kina barâ°m! se shjelmi jot / tha / nuk em bâ° gjâ° m^u! edhe tak e vrau / ene hiku //
- sh³t³n shkadrâ°nt / nuk mun e majtën / ra m Kavaçe // i thot i plake: sha çil derën t hyj mrên!
- pse? tha //
- se kam bâ° nâ°min / tha / s^ht //
- ene plaka e çeli derën / ene e futi mrên // ene e mylli Sufa derën //

E tregoi *Lik Metani* (70 vjeç)
Krujë

KONKLUZION

Zona gjuhësore Krujë — Mafsheq — Cudhin shtrihet në pjesën veriore të Shqipërisë së Mesme. Shumica e tipareve dialektore të kësaj zone janë të nëndialektit të Shqipërisë së Mesme, ose të gegërishtes jugore, sidomos të të folmeve të anës perëndimore të këtij nëndialekti, të këtilla janë:

$\hat{a} > \hat{a}^\circ$ (*kâ°ma*, *llâ°na*, *bâ°*); *a* që ndodhet pas bashkëtingëlloreve nazale kalon në \hat{a}° (*gimâ°sre*, *mâ°gje*, *knâ°qte*); *o* e patheksuar në rrokje nistore jep *a* (*kanâ°qe*, *mator*, *kadit*, *katec*); *u* e patheksuar që ndodhet para *l*, *ll*, *r* ka dhënë \ddot{e} (*sjetëll*, *vetëll*, *akëll*, *flutër*); diftongjet *ve*, *ye*, *ie* janë monoftonguar (*shull*, *grue*, *me p Φ t*, *kr Φ* , *dill*, *me zi*); fenomeni *h > f* ka përfshirë një numur të madh rastesh (*mçef*, *rrafa*, *stofët*, *dufëm*); bashkëtingëlloret *q*, *gj* nuk janë zhvilluar më tej; grupet e vjetër *kl*, *gl* kanë dhënë respektivisht *q*, *gj* (*qan*, *qumësh*, *i gjat*, *gjuni*); grupet *mb*, *nd* janë asimiluar duke përfunduar në *m*, *n* sonante (*mrapa*, *pamuk*, *nodhen*, *kanila*); ekziston grupi *msh* në vend të grupit *fsh* (*msh^his*, *msh^hëll*); emrat mashkullorë që mbarojnë në të pashquar me *u* (<ue), kur shquhen, nuk nxjerrin bashkëting. *n* të temës së vjetër (*ftū-ftoi*); ekziston forma e rasës vendore (*n rakit*, *për g^uoet*, *me Mirditët*); trajtat *im* (mashk) *ime* (fem.) të përemrave pronorë veta e parë kur prona dhe pronari janë njëjës në rasën emrore; format *tat* (mashk.) dhe *tate* (fem.) të rasave të zhdrejta të përemrave pronorë të vetës së dytë kur prona dhe pronari janë njëjës (megjithëse më tepër ndeshet në të folmen e qytetit); janë pa mbaresë vetore foljet e zgjedhimit të tretë mënyra dëftore koha e tashme veta e dytë dhe e tretë njëjës (*pno*, *bâ°*, *la*); forma foljore e së ardhëshmes *kam + për + emër foljor asjanës i pashquar* (*kam për t shkue*); përdorimi më i vogël sintaktik i formës foljore të paskajores; fjalë nga leksiku i Shqipërisë së Mesme e ndonjë fenomen tjetër.

Këto të folme që shtrihen në V. të Shqipërisë së Mesme, ndodhen afër të folmeve më veriore geqe, prandaj aty shihen edhe disa tipare të gegërishtes veriore, si: $\hat{e} > \hat{e}^\circ$ (*mr^hen*, *rrëj*, *z Φ*); kalimi $e > \epsilon$ në shumë raste (*xh ϵ p*, *v ϵ t*, *tu h ϵ c*); zberthimi i *e* së mbyllur që ndodhet pranë bashkëtingëlloreve qiellzore dhe *l*-së në *ie*; (*me g^l qlet*, *bereq^letin*, *pl^heshta*, *l^hek*); zhvillimi i *nj*-së së disa pozitave të caktuara në *ni*, *n'* ose *n* (*i niom*, *të n^hefsh*, *nifem*); forma *ta°ne* e rasave të zhdrejta të përemrit pronor veta e dytë njëjës që vërehet shpesh në Malësi, forma e aoristit asigmatik (*u xarrova*, *u lava*) e ndonjë tjetër.

Megjithëse të folmet e qytetit dhe të Malësisë janë shumë të afërta prapëseprapë diçka dallohen ndërmjet tyre: në Malësi zanorja *e* në disa raste është diftonguar në *ie* (*gief*, *lieh*), kurse në Krujë nuk haset ky fenomen; në Malësi ekziston edhe varianti *e^h* i diftongjeve të ardhur nga zberthimi i *i*-së; në Krujë *y* ka dhënë kryesisht Φ (*kr Φ p*), kurse në Malësi ka dhënë Ψ dhe ω , nga të cilat varianti i dytë (ω) është më i përhapur; në Krujë *u* e theksuar është zber-

thyer në *ou* ose ka dhënë *o*, kurse në Malësi nuk ka evoluar kjo zanore. Edhe zanorja *o* e theksuar ka kaluar në diftongoid *uo* pothuajse vetëm për qytetin e Krujës; diftongu *ie* në Malësi në më shumë raste nuk është monofonguar, kurse në Krujë ka ndodhur e kundërta; në katundin Cudhin të Malësisë grupi *ng* është reduktuar në *g*, në Kurbi e gjejmë të pa ndryshuar këtë grup, kurse në Krujë ai është asimiluar dhe ka dhënë *ŋ* sonante; ndërsa në Krujë gjejmë formën *tat-tate* të Shqipërisë së Mesme për rasat e zhdrejta të përemrit pronorë veta e dytë njëjës, në Malësi mbizotëron forma *taⁿ-ta^one* e të folmeve gegë më veriore; në Malësi foljet veprorë të mënyrës dëftore koha e pakryer dalin më shpesh me mbaresat *-she* (*-jshe*) për vetën e parë njëjës dhe me mbaresat *-te* dhe *-nte* për vetën e tretë njëjës, kurse në Krujë dalin më tepër me mbaresat *-shem* (*-jshem*) veta e parë dhe me mbaresat *-nte*, *-te*, *-jte* veta e tretë, nuk po përmëndin dallimet në leksik e ndonjë dallim tjetër jo fort të rëndësishëm nga sfera e fonetikës dhe morfologjisë.

Si tipar dialektor më karakteristik i kësaj zone ishte, siç e pamë, evolimi i shumë zanoreve të theksuara; kalimi i disave në zanore më të hapta dhe zbërthimi i disa prej tyre në disa pozita të caktuara: zanorja *y* ka dhënë *ϕ*, *æ*, *ɣ* ose *i* (*tϕm*, *përmϕs*, *oell*, *nroedhe!*, *slpɣrti*, *ktyne*, *ija*, *gjimi*); zanorja *u* ka dhënë *ʔ* ose diftongoidin *o^u* (*rr^og*, *tɔf*, *po^un*, *katro^uve*); zanorja *o* ka dhënë *Λ* dhe diftongoidin *uo* (*kΛs*, *kΛlt*, *zΛgjɔ*, *shk^uopi*, *c^uopa*, *c^uorb*); *i* është diftonguar duke dhënë më tepër *ɔⁱ* dhe herëherë edhe *ei* ose *ɛ* (*mɔⁱr*, *ka pɔⁱna*, *tɔⁱ*, *dheⁱt*, *mtɔⁱ vrɛtⁱn!* *mërdheⁱf*). Për shkak të këtyre tipareve dialektore kryesore këto të folme mund të afrohen e mund të radhiten me të folmet e anës veriore të Shqipërisë së Mesme, d.m.th. me ato të Matit dhe të Dibrës.

R é s u m é

OBSERVATIONS SUR LE PARLER DE KRUIJE ET DE LA MALESSIE DE KRUIJE

Dans ce travail sont ébauchés les résultats des remarques faites en 1960 et 1961 sur les parlers de la ville de Kruje et des villages limitrophes de la Malessie: Cudhi et Mafsheq. Ces agglomérations du triangle linguistique ne sont distantes que de 7-8 km. en moyenne.

La zone des parles, dont il est question ici, est montueuse: elle appartient à l'Albanie centrale. Les habitants des villages de Cudhi et Mafsheq ont été en continuel rapport avec la ville de Kruje, cette dernière faisant depuis des siècles et continuant encore de nos jours à faire la fonction de chef-lieu économique et administratif de son arrondissement. Ces rapports continus et d'autres raisons sociales expliquent parfaitement la grande unité existante entre les parlers de ces trois points. Simultanément, entre ceux-ci existent également des différences dialectales.

Ces parlers présentent, au même titre que les autres parlers de l'arrondissement de Kruje, les traits principaux du sous-dialecte du guègue méridional, notamment des parlers de sa partie occidentale, tandis que les traits les plus particuliers communs vont au groupe des parlers septentrionaux de ce sous-dialecte, c'est-à-dire de ces parlers qui ont comme trait caractéristique la diphtongaison de la voyelle *i* et qui s'étendent depuis le cours de l'Ishëm à l'Ouest jusqu'à la Dibra à l'Est, et depuis le Fand au Nord jusqu'à la Mallessie de Tirana au Sud.

Etant donné que les parlers de Kruje, Cudhi et Mafsheq ont une position

septentrionale en Albanie centrale, ils reflètent également des traits propres aux parlars septentrionaux du dialecte guègue.

Traits du sous-dialecte guègue méridional :

â > â° (kâ°ma, llâ°na, bâ°); l'a derrière les consonnes nasales passe en â° (qimâ°sre, mâ°gje, knâ°qte); l'o inaccentué en syllabe initiale donne a (kanâ°qe, mator, kadit, katec); l'u inaccentué devant l, ll, r a donné ë (sjetëll, vetëll, akëll, flutër); les diphtongues ue, ye, ie ont été réduites en monophthongues (shull, gru, me p^ot, kr^o, dill, me zi); le phénomène h > f a embrassé un grand nombre de cas (mçef, rrafa, ftofët, dufëm); les consonnes q, gj n'ont pas enregistré d'évolution ultérieure; les groupes anciens kl, gl ont donné respectivement q, gj (qan, qumësht, i gjat, gjûni); les groupes mb, ndont abouti par assimilation en m, n sonante (mrapa, pamuk, nodhen, kanila); on a la présence du groupe msh au lieu de celui fsh (mshais, mshëikëll; les noms masculins se terminant en u à l'indéterminé (<ue), quand ils passent au déterminé, ne portent plus l'n de l'ancien thème (ftû-ftoi); existe la forme du locatif (n rakit, për g^uoct, me Mir-ditët); les formes im (masc), et ime (fém.) des possessifs première personne, quand l'être ou la chose qui possède sont au nominatif singulier; les format tat (masc.) et tate (fém.) des cas obliques des possessifs de deuxième personne quand l'être ou la chose qui possède sont au singulier (quoique cette forme soit rencontrée la plupart du temps dans le parlars de la ville); sont sans désinence personnelle les verbes de la troisième conjugaison, indicatif présent deuxième et troisième personne du singulier (pno, bâ°, la); la forme verbale du futur kam + për + nom verbal neutre indéterminé (kam për të shkue); usage syntaxique plus restreint de la forme verbale de l'infinitif; mots du lexique de l'Albanie centrale et quelque autre phénomène.

Traits du guègue septentrional:

La voyelle y a donné \varnothing , oe, y ou i (t^om, për^os, oell, nroedhe, shpyrti, ktyne, ija, gjimi); la voyelle u a donné $\overset{\circ}{o}$ ou la diphtongoïde o^u (rr^og, t^of, po^un, katro^uve); la voyelle o a donné \wedge ou \bar{a} la diphtongoïde ^uo (k \wedge s, k \wedge lt, z \wedge gjt, shk^uopi, c^uopa, c^uorb); l'i a été diphtonguisé en donnant plutôt \exists i et tantôt ϵ i ou ϵ (m \exists r, kapt \exists na, t \exists i, dheit, mtei, vretni! mërdhef.

Traits du groupe septentrional du guègue méridional:

e > ϵ dans un grand nombre de cas (xhëp, vët, tu hëç); diphtogaison du e fermé devant les consonnes palatales et de l'l en ie: (me gā qiet, bereq^{ie}.in, p^{ie}shhta, l^{ie}ek); évolution du nj dans certaines positions données en ni, n' ou n i niom, të n'efsh, nifem); la forme ta^{ne} des cas obliques du possessif à la deuxième personne qu'on observe souvent dans la Malessie, la forme de l'aoriste asygmatische (u xarrova, u lava) et quelque autre.